



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1022/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P “Ballabani Komerc”, me nr. të biznesit 80047134 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, lokali nr. 22/95, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat F.P. me zyre në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 94/23 të datës 31.05.2023, të Përmbartuesit Privat Isak Islami, nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 20.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P “Ballabani Komerc” ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 94/23 i datës 31.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore, Sh.a, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr. 94/23 të datës 31.05.2023 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit: Faturë kthyese me nr. 2023/01630 dhe Ekstraktit të verifikuar nga Librat e Kontabilitetit të dt. 31.05.2023 ashtu që është detyruar debitori N.T.P “Ballabani Komerc” që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga fatura dhe kartela e lartcekur, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 1,823.05 EUR (me shkronja: njëmijë e tetëqind e njëzet e tre euro e zero pesë euro cent) me kamatëvonesë prej 8% në vit duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e përmbartimit nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përmbartimor nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Ka shtuar se mbetet e paqartë se propozimi në fjalë mbështetet në faturën nr. 2023/01630 të datës 01.05.2023, apo mbi kartelën financiare të datës 31.05.2023, sepse fatura nr. 2023/01630 e datës 01.05.2023 nuk përbën titull përmbartimor për shumën e treguar në propozimin për përmbartim sepse shuma totale e saj është 593.11 €, çka nuk përputhet me shumën totale të treguar në propozimin për përmbartim prej 1,823.05 €, kurse kartela financiare e datës 31.05.2023 nuk përbën dokument të përshtatshëm për përmbartim sepse nuk hyn në asnjërën prej kategorive të parapara sipas nenit 29, par. 1 të LPP-së, sepse e njëjta nuk mund të cilësohet si ekstrakt i verifikuar nga librat afarist, për arsye se nuk i referohet pagesës së shërbimeve komunale të furnizimit më ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se debitori në prapësimin e tij nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ekziston ndonjëra nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, andaj pretendimet e tij në prapësim nuk e lirojnë debitorin nga pagimi i detyrimit që rrjedhë nga kontrata e qirasë për lokalin afarist. Ka shtuar pretendimet e debitorit lidhur me mungesën e tipareve të përmbartueshmërisë së faturës nr. 2023/01630 të datës 01.05.2023 nuk qëndrojnë për faktin se e njëjta është pranuar nga debitori dhe nuk është kontestuar nga i njëjti, si dhe është përshkruar shuma e borxhit për muajin maj 2023 si dhe shuma e përgjithshme e borxhit prej 30,117.14 €. Duke qenë se me nenin 69, par. 4 të LPP-së, është përcaktuar se baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura, si dhe debitori nuk i ka argumentuar pretendimet e tij me prova, kreditori i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste*

për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“, kurse me nenin 37 të LPP-së.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se fatura me nr. 2023/01630 e datës 01.05.2023 nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, pasi që faturës në fjalë i mungon objekti i saktë i detyrimit, kjo për faktin se në propozimin për përmbarrim, kreditori ka kërkuar realizimin e borxhit në vlerë prej 1,823.05 EUR, ndërsa në faturën e bashkangjitur në propozim, janë pasqyruar dy vlera tjera, dhe atë, shuma prej 593.11 EUR si faturë mujore e muajit maj 2023 dhe borxhi total prej 30,117.14 EUR, andaj nuk dihet se cili është detyrimi që kreditori kërkon ta realizoj nga dokumenti i besueshëm dhe cilës periudhë kohore i përket.

Përveç të metave si më lartë, Gjykata gjen se fatura nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, pasi që tek pranuesi i faturës mungon nënshkrimi apo vula e biznesit të debitorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën dëshmohet se kjo faturë i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë të rregullt ashtu që debitori të jetë i njoftuar me detyrimin që rrjedh nga kjo faturë.

Me rastin e vendosjes, Gjykata vlerësoi edhe dokumentin kartelë financiare të datës 31.05.2023 të cilën kreditori i ka bashkangjitur propozimit për përmbarrim, por që e njëjta, po ashtu nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm nga neni 29 par. 1 nën par. 1.2 të LPP-së, sepse në kuptim të dispozitës së lartcekur, është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave por jo edhe kartelat financiare në emër të shërbimeve të qirasë.

Nga të lartcekurat, meqenëse dokumenti faturë nr. 2023/01630 e datës 01.05.2023 nuk është i përshtatshëm për përmbarrim për shkak të të metave në objektin e detyrimit të saj, ndërsa kartela financiare e datës 31.05.2023 nuk paraqet dokument të besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, Gjykata vendosi që urdhri për lejimin e përmbarrimit të shfuqizohet.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, si dhe

nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1022/23, datë 20.12.2023

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.